



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit

S- 024

Prishtinë, më 5 qershor 2008, në orën 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

P R O C E S V E R B A L

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
5 QERSHOR 2008

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 84 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendi, në bazë të Vendimit të Kuvendit, dt. 15 shkurt 2008, për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuar në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin lidhur me të, sipas procedurës së veçantë, ka përgatitur dhe Kuvendit për seancën e sotme ia ka paraqitur këtë

R e n d d i t e:

- 1. Shqyrtimi i dytë i Grupit të katërt të projektligjeve nga Propozimi i Martti Ahtisaarit, sipas procedurës së veçantë:**

- 1.1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës,
- 1.2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës,
- 1.3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës,
- 1.4 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës,
- 1.5 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për hekurudhat e Kosovës.

Kuvendi i vazhdoi punimet sipas rendit të ditës të propozuar.

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës

Kryetari ftoi kryesuesin e Komisionit ad-hoc, **Fehmi Mujota**, t'i arsyetojë rekomandimet e Komisionit për këtë projektligj.

Deputeti **Fehmi Mujota** tha se Komisioni ad-hoc, në bazë të vendimit të Kuvendit të Kosovës, datë 15 shkurt 2008, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2008, ka shqyrtuar projektligjet e grupit të katërt të projektligjeve të miratuara në seancën e mëparshme dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Komisioni, pasi shqyrtoi Projektligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, njëzëri vendosi t'i rekomandojë Kuvendit ta miratojë Projektligjin me 13 amendamente të propozuara.

Kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit ad-hoc në Projektligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Kuvendi, me shumicë votash, miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13.

Amendamenti 10 u miratua sipas propozimit të zëvendës kryeministrit, Hajredin Kuçi, që të hiqet fjala "komunitet" para fjalëve "shumicë shqiptare", ndërsa pjesa tjetër mbetet e pandryshuar.

Pastaj, Kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 64;
Kundër-----10;
Abstenime-----7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës

Kryetari ftoi kryesuesin e Komisionit ad-hoc, Fehmi Mujota, ta arsyetojë Raportin me rekomandime për Projektligjin për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës.

Deputeti **Fehmi Mujota** tha se Komisioni ad hoc ka shqyrtuar Projektligjin për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës dhe njëzëri ka vendosur t'i rekomandojë Kuvendit miratimin e Projektligjit me amendamentet e propozuara.

Kryetari i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e propozuara nga Komisioni ad-hoc.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, dhe 3.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 76;
Kundër----- 0.
Abstenime-----8.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e propozuara nga Komisioni ad-hoc në Projektligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2 dhe 3.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 79;
Kundër----- 1.
Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës

Komisioni ad hoc kishte shqyrtuar Projektligjin për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës dhe Kuvendit i kishte rekomanduar ta miratojë atë në formën e propozuar.

Kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 81;
Kundër----- 0.
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për hekurudhat e Kosovës

Komisioni ad hoc kishte shqyrtuar Projektligjin për hekurudhat e Kosovës dhe Kuvendit i kishte rekomanduar ta miratojë atë në formën e propozuar.

Kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 81;

Kundër----- 0.

Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për hekurudhat e Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 15:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale